



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.

DREJTORIA E PROKURIMIT DHE ANKANDIT

Nr. _____ Prot.

Patos, më ___/ 06/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Projekt per website te ri per shoqerine Albpetrol sha ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): [72413000-8](#)
sherbimet e projektimit te faqeve per world wide web

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,985,000 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë)lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se se 40 % të vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP dhe ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si deshmi për pervojën e mëparshme kërkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OSE

Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë pervojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO ose të përditësuara, ose ekuivalente (të vlefshme dhe të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certificate ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente me të.

Arsyetimi: Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

- Operatori Ekonomik duhet të paraqese Certifikate ISO 20000-1:2011 mbi “Menaxhimin e shërbimit për teknologjine e informacionit” ose ekuivalente me te.

Arsyetimi: Ky standard është i nevojshëm për të specifikuar kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të shërbimit. Ky sistem mbështet menaxhimin e ciklit jetësor të shërbimit, duke përfshirë planifikimin, projektimin, tranzicionin, shpërndarjen dhe përmirësimin e shërbimeve, të cilat përmbushin kërkesat e dakorduara dhe japin vlerë për konsumatorët, përdoruesit dhe organizatën që ofron shërbime. Ky standard u jep kompanive mundësinë të demonstrojnë aftësitë profesionale të tyre në zbatimin e projekteve të teknologjisë së informacionit.

- Operatori Ekonomik duhet të paraqese Certifikate ISO 22301: 2012 mbi “Krijimin dhe mirembajtjen e vazhdueshme dhe sigurise se sistemeve te menaxhimit”ose ekuivalente me te.

Arsyetimi: Ky standard është i nevojshëm pasi është projektuar për të ndihmuar organizatat të parandalojnë, përgatiten, përgjigjen dhe rikuperohen nga incidentet e papritura që shkaktojnë ndërprerje të punës. Ky standard u jep kompanive mundësinë të demonstrojnë aftësitë profesionale të tyre në zbatimin e projekteve të teknologjisë së informacionit.

- Operatori Ekonomik duhet të paraqese Certifikate ISO 27001:2013 mbi “Sistemet e menaxhimit te sigurise informatike”ose ekuivalente me te.

Arsyetimi: Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura

Sa më sipër janë kërkuar çertifikata që të vërtetojnë se ofertuesit kanë sisteme menaxhimi sipas standarteve ndërkombëtare të cilat reflektojnë dukshëm edhe në cilësinë e shërbimit. Kërkesat janë të mjaftueshme për të siguruar ofertues me kapacitete teknike cilësore të çertifikuar edhe me çertifikata menaxhimi të cilësisë të njohura ndërkombëtarë. Çertifikatat e kërkuara për OE janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Çertifikatat e kërkuara janë vendosur në përputhje me specifikimet teknike si dhe u arsyetuan të nevojshme për të siguruar ofertues serioze.

- 2.3.3. Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontrates, për planifikimin dhe manaxhimin

me profesionalizëm të punës Operatori ekonomik duhet të ketë në listpagese minimumi 4 (kater) punonjes të diplomuar në nga nga degët (Informatike/Teknologji- Informacioni/Elektronike) të kualifikuar me implementimin, evidentimin dhe mbështetjen e implementimit të projektit duke pasur njohuri të kombinuar sipas kërkesave të mëposhtme:

Për secin punonjes të paraqiten:

- Diploma përkatëse.
- Listepagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat punonjësit e sipërpërmendur duhet të figurojnë.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë staf teknik të kualifikuar sipas certifikatave të mëposhtme:

- Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar si menaxher projekti në fushën e menaxhimit të projekteve (PMP / PRINCE 2) ose ekuivalente.

Arsyetim: Ky certifikim na ndihmon për të vlerësuar aftësitë në menaxhimin dhe zbatimin e projekteve të operatorit ekonomik.

- Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar në fushën e sigurisë së sistemeve të informacionit.

Arsyetim: Ky certifikim është kriter i rëndësishëm për perzgjedhjen e operatorit ekonomik sepse website do të instalohet platforma të sigurtë nga ana e sigurisë kibernetike.

- Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar për databazat në nivelin ekspert.
Ky certifikim është kriter i rëndësishëm për operatorin ekonomik i cili do të ndërtojë databasë të strukturuar dhe ndërtuar cilësisht për website.

- Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar si administrator Database.

Ky certifikim është kriter i rëndësishëm për operatorin ekonomik i cili do të administrojë dhe mirëmbajë databasën e website

- Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalent.

Ky certifikim është kriter i rëndësishëm për operatorin ekonomik i cili duhet të ketë njohuri themelore në fushën e IT-së, Kjo certifikatë është një Standart global dhe posedimi

i saj ka për qëllim të japë një kuptim fundamental sa i përket njohurive të thelluara rreth praktikave të ITIL-it për profesionistët e IT-së.

- Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar për "Software Business Analyst" ose ekuivalent.

Albpetrol Sha është një shoqëri tregtare e cila operon në fushën e tregtimit të naftës bruto dhe Certifikimi Software Business Analyst është një kriter i rëndësishëm për operatorin ekonomik i cili do të ndërtojë e website-in e kësaj shoqërie. Certifikimi tregon se një person ka njohuri të specializuara dhe aftësi në analizën e biznesit dhe zhvillimin e software-ve të biznesit. Kjo mund të përfshijë aftësitë për të identifikuar dhe vlerësuar nevojat e biznesit, për të zhvilluar specifikimet e software-it, për të hartuar modele të biznesit dhe për të menaxhuar ndryshimet e nevojshme gjatë zhvillimit të projektit. Kur një ndërtues website është i certifikuar si Software Business Analyst, kjo tregon se ata kanë një përbërje të gjerë të aftësive dhe njohurive të nevojshme për të kuptuar dhe përmbushur kërkesat e biznesit për një website. Në këtë mënyrë, ata mund të ndihmojnë në sigurimin e qëllimeve të projektit dhe në adresimin e nevojave të përdoruesve të faqes.

- Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar në Unified Modeling Language (UML) ose ekuivalente.

Certifikimi në Unified Modeling Language (UML) është një kriter i rëndësishëm për një operator ekonomik në ndërtimin e një website. UML është një gjuhë standarde modelimi që përdoret për të përshkruar dhe vizualizuar strukturën dhe sjelljen e sistemeve të ndryshme softuerike. Kur një ndërtues website-esh është i certifikuar në UML, kjo tregon se ata kanë njohuri të specializuara dhe aftësi në përdorimin e kësaj gjuhe për të modeluar dhe komunikuar përmbajtjen e sistemeve softuerike. UML ofron një set të pasur të elementeve dhe koncepteve modeluese që mund të përdoren për të krijuar diagrame të strukturave, diagrame të sjelljeve, diagrame të proceseve, dhe shumë të tjera që mund të jenë të dobishme gjatë zhvillimit të një website. Certifikimi në UML gjithashtu tregon angazhimin e një personi ndaj zhvillimit profesional dhe një përqendrim të tyre në përmirësimin e aftësive të tyre në modelimin e sistemeve softuerike.

- Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar si Specialist në Programming HTML5 me Java Script dhe CSS3.

Certifikimi si Specialist në Programming HTML5 me Java Script dhe CSS3 mund të jetë një kriter i rëndësishëm për një operator ekonomik në ndërtimin e një website. HTML5, Java Script dhe CSS3 janë teknologjitë kryesore që përdoren për të zhvilluar dhe stilizuar faqet e internetit. Kur një ndërtues website është i certifikuar si Specialist në këto teknologji, kjo tregon se ata kanë njohuri të thella dhe aftësi të specializuara në

programimin e HTML5, Java Script dhe CSS3. Këto gjuhë dhe teknologji përdoren për të krijuar dhe rregulluar elementet e faqes së internetit, për të krijuar interaktivitetin dhe për të stilizuar faqen në mënyrë estetike. Certifikimi tregon angazhimin e një personi ndaj përmirësimit të aftësive të tyre në programim dhe përdorimit të teknologjive të reja. Punonjësi që ka fituar një certifikim të tillë tregon se ata janë të gatshëm të përdorin praktikatat më të mira dhe standardet e industriës për të krijuar dhe menaxhuar faqet e internetit. Gjithashtu, certifikimi mund të tregojë se një punëtor ka një bazë të thellë të dijeve në programim dhe kuptimin e koncepteve thelbësore të zhvillimit web. Kjo mund të jepet përparësi në përzgjedhjen e një kandidati për ndërtimin e një website. Megjithatë, është e rëndësishme të kuptoni se certifikimi vetëm nuk është një garantim i përmbushjes së detyrave apo suksesit në punën e ndërtimit të një website. Aftësitë praktike, përvoja e punës në projekte të ngjashme, kreativiteti dhe njohuria e teknologjive të tjera të përdorura në ndërtimin e faqeve të internetit janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm për të qenë një punonjës i suksesshëm në këtë fushë. Në përfundim, certifikimi si Specialist në Programming HTML5 me Java Script dhe CSS3 mund të jetë një kriter i rëndësishëm për një punonjës pjesëmarrës në ndërtimin e një website, duke treguar njohuritë dhe aftësitë e tyre të specializuara në programim dhe përdorimin e teknologjive kryesore të zhvillimit web. Megjithatë, është e rëndësishme të vlerësoni edhe faktorë të tjerë si përvojën praktike, kreativitetin dhe njohurinë e teknologjive të tjera për të vlerësuar aftësitë e një punonjësi në këtë fushë.

- Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar si zhvillues profesional software.

Certifikimi si zhvillues profesional i software është një kriter i rëndësishëm për një punëtor pjesëmarrës në ndërtimin e një website. Zhvillimi i një website kërkon njohuri dhe aftësi të specializuara në programim dhe zhvillim software.

Kur një ndërtues website është i certifikuar si zhvillues profesional i software, kjo tregon se ata kanë një nivel të përcaktuar të dijes dhe aftësive në programim dhe zhvillim software. Certifikimi tregon se një person ka përmbushur kriteret e nevojshme dhe ka demonstruar njohuritë dhe aftësitë e tyre në fushën e zhvillimit të software-ve. Kjo mund të përfshijë njohuritë e thella të një gjuhe programimi specifike, siç është Python, Java, C++, etj., si dhe aftësitë në modelimin e bazave të të dhënave, strukturën e dhenave, algoritmet, dhe zhvillimin e aplikacioneve të sofistikuar.

Certifikimi si zhvillues profesional i software gjithashtu tregon angazhimin e një personi ndaj rritjes dhe zhvillimit profesional. Punonjësi që ka fituar një certifikim të tillë tregon se ata janë të përkushtuar në profesionin e tyre dhe kanë investuar kohë dhe energji në zgjerimin e njohurive dhe aftësive të tyre në zhvillim software.

Për ndërtimin e një website, një zhvillues profesional i software do të ketë njohuri dhe aftësi të përshtatshme për të përdorur gjuhët programuese të nevojshme për zhvillimin e faqes, për të lidhur dhe manipuluar bazën e të dhënave, për të siguruar ndërveprimin me përdoruesit dhe për të zhvilluar funksionalitete të avancuara. Kjo i bën ata një zgjedhje të mirë për një punonjës pjesëmarrës në ndërtimin e një website.

Megjithatë, duhet të theksohet se certifikimi vetëm nuk është një garantim i përbushjes së detyrave apo suksesit në punën e ndërtimit të një website. Aftësitë praktike, përvoja e punës, kreativiteti dhe njohuria e teknologjive të tjera të përdorura në ndërtimin e faqeve të internetit janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm për të qenë një punonjës i suksesshëm në këtë fushë.

Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikatë, por që në mënyrë të kombinuar stafi të plotësojë minimumin e certifikatave/dëshmimeve të kërkuara.

Për secin punonjës të paraqiten:

- Certifikata përkatëse.
- Listepagesat e shoqërisë për të pakten tre muajt e fundit në të cilat punonjësit me certifikatat e sipërpërmendura duhet të figurojnë.

Shënim: Për përbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës pranë Autoritetit Kontraktor të cilët kanë njohuri të posaçme për objektin e prokurimit. *Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Njësia e Prokurimit: